



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 790/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga : Agon Ramadani Kryetarë, Kimete Gashi Antare dhe Vedat Poterqoi Antarë duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Eor Group”sh.p.k& “Contanti Generators” sh.p.k me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Gjenerator” me nr. të prokurimit: 651-22-12442-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Gjilanit, me datën 24.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e parashtruar nga operatori ekonomik “Eor Group”sh.p.k& “Contanti Generators” sh.p.k me seli në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 21.12.2022 (me numër protokollit 790/2022) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Gjenerator” me nr. të prokurimit: 651-22-12442-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjilanit.

II. Anullohet, Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Gjenerator” me nr. të prokurimit: 651-22-12442-1-1-1, ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër kthehet në **rivlerësim**.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

IV. Me qenë se ankesa e Operatorit Ekonomik “Eor Group”sh.p.k& “Contanti Generators” sh.p.k me seli në Prishtinë, aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08.12.2022, Komuna e Gjilanit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për Dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Gjenerator” me nr. të prokurimit: 651-22-12442-1-1-1,ku është rekomanduar për kontratë OE “Infinit” sh.p.k.

Me datë 11.12.2022, Operatori Ekonomik “Eor Group”sh.p.k& “Contanti Generators” sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Gjilanit, me datë 12.12.2022, AK Komuna e Gjilanit e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 08.12.2022.

Me datën 21.12.2022 Operatori Ekonomik “Eor Group”sh.p.k& “Contanti Generators” sh.p.k ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 790/2022, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur-furnizim, vlerë të madhe, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët vlera e parashikuar e kontratës: 160,350.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës. AK Komuna Gjilan, bazuar në shkresat e lëndës nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa OE ankues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.12.2022, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “Eor Group”sh.p.k& “Contanti Generators” sh.p.k të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 08.12.2022 për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

-Seanca dëgjimore

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Eor Group”sh.p.k& “Contanti Generators” sh.p.k.

Pretendimi nr. 1

Sqarim hyrës:

Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit ka iniciuar aktivitet të prokurimit me titull: “Furnizim me Gjenerator” me nr. të prokurimit: 651-22-12442-1-1-1, gjatë këtij aktiviteti ka zbatuar procedurë të hapur - lloji i kontratës është furnizim, vlerë e madhe kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët.

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë kundër propozimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, AK ka rekomanduar për kontrate OE: “INFINITT” SH.P.K.

Përgjigje në Pretendime 1:

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik “INFINITT” SH.P.K. ka plotësuar “kërkesën për sekret afarist” të dosjes së tenderit tek pjesa Aneksi 3 të cilën e ka plotësuar dhe e ka nënshkruar dhe ky pretendim është si i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendime 2:

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik “Eor Group” sh.p.k & Contanti Generators - Prishtinë, si parashtrues i ankesës pretendon se AK nuk ka lejuar qasje në dokumente zyrtare sipas kërkesës se OE ankues, ku AK ka ofruar qasje në dokumente zyrtare me datë: 09.12.2022 si: Certifikata e biznesit (ARBK + Autorizimi Auka), Deklaratat, Formulari i tenderit.

Bazuar në pretendimet e OE ankues ku dëshmon përmes shkresave zyrtare që AK nuk i ka dhënë qasje OE ankues në të gjitha dokumentet por vetëm në disa dokumente si: Certifikata e biznesit (ARBK + Autorizimi Auka), Deklaratat, Formulari i tenderit është shkelje e dispozitave të LPP-se konkretisht nenin 7, 11, për arsye se nuk mundet OE i rekomanduar për kontratë të paraqes shumicën e dokumenteve si sekrete afariste. Në bazë të RRUOP pika 7, divizioni i prokurimit do t'i ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit.

Në këtë rast autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 11 pika 4 të LPP-se, për arsye se nuk e ka përgatitë versionin e "pastruar" për t'i njoftuar OE pjesëmarrës për këtë aktivitet, por edhe nëse e përgatitë këtë version duhet të jete në dijeni se cilat dokumente mund t'i fusë si dokumente afariste. Pamundësi, pabarazi dhe diskriminimi i trajtimit të gjithë operatoreve ekonomik nënkupton eliminim apo favorizim të ndonjë operatori ekonomik.

Autoriteti kontraktues me datë 12.09.2022, ja ka mundësuar qasjen OE ankues, vetëm në këto dokumente:

Certifikata e biznesit (ARBK + Autorizimi Auka);

Deklaratat;

Formulari i tenderit.

Andaj, mendimi i ekspertit shqyrtues, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore i vlerësohen si të bazuar për arsye se zyra e prokurimit nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e larte cekuar, ku njëkohësisht ja ka pamundësuar OE ankues qasjen në ofertën e OE të rekomanduar për kontrate.

Për të gjitha pikat ku pretendon OE se ka falsifikuar referenca, JU si palë ankueses mund ti drejtoheni organeve kompetente.

Mendimi i ekspertit është që AK-Komuna Gjilanit t'i a mundëson qasjen OE ankues në dokumentet e OE të rekomanduar për kontrate, ashtu siç e parasheh nenin 11 i LPP-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandojmë që lënda të kthehet në rivlerësim.

-Konstatimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar “kërkesën për seret afarist”, pasi që nga shkresat e dosjes së lëndës shihet qartë OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar “kërkesën për sekret afarist” të dosjes së tenderit tek pjesa Aneksi 3 të cilën e ka plotësuar dhe e ka nënshkruar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues i cili pretendon se AK nuk ka lejuar qasje në dokumente zyrtare sipas kërkesës se OE ankues, paneli shqyrtues sqaron se AK komuna e Gjilanit i ka ofruar qasje në vetëm këto dokumente zyrtare me datë: 09.12.2022 si: Certifikata e biznesit (ARBK + Autorizimi Auka), Deklaratat, Formulari i tenderit.

Prandaj bazuar në pretendimet e OE ankues ku dëshmon përmes shkresave zyrtare që AK nuk i ka dhënë qasje OE ankues në të gjitha dokumentet por vetëm në disa dokumente si: Certifikata e biznesit (ARBK + Autorizimi Auka), Deklaratat, Formulari i tenderit është shkelje e dispozitave të LPP-se konkretisht nenin 7, 11, për arsye se nuk qëndron në harmoni me tiparet themelore të LPP-së që një OE ti paraqes shumicën e dokumenteve si sekrete afariste.

Në bazë të RRUOP pika 7, divizioni i prokurimit do t'i ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit.

Me tutje paneli vlerëson se në këtë rast autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 11 pika 4 të LPP-se, për arsye se ka mundur që ta përgatisë versionin e “pastruar” për t'i njoftuar OE pjesëmarrës për këtë aktivitet, por edhe nëse e përgatitë këtë version duhet të jete në dijeni se cilat dokumente mund t'i futë si dokumente afariste. Pamundësi, pabarazi dhe diskriminimi i trajtimit të gjithë operatoreve ekonomik nënkupton krijim hapësirash për eliminim apo favorizim të ndonjë operatori ekonomik.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE “Eor Group” sh.p.k& “Contanti Generators” sh.p.k, të aprovohet si e bazuar, si dhe konform mendimit të raportit të ekspertit shqyrtues të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 08.12.2022 për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjatë procedurave të rivlerësimit, obligohet AK që ti jap qasje OE ankues konform dispozitave të lartpërmendura, e poashtu të bëhet rivlerësimi i ofertave konform ligjit të LPP-së, përkatësisht nenit 59 e 60 të LPP-së, duke u bazuar poashtu në kriteret e parashtruara për dhënien e kontratës nga AK, e poashtu në relacion me pretendimet ankimore të OE ankues

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gjilanit

1x1 OE "Eor Group" sh.p.k & "Contanti Generators" sh.p.k me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.